

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Katër faktorët që e bëjnë Barcelonën pretendente për Ligën e Kampionëve këtë sezon
ADRESA	https://albeu.com/sport/kater-faktoret-qe-e-bejne-barcelonen-pretendente-per-ligen-e-kampioneve-kete-sezon/1009039/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 21:23:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 21:20:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	065e6422c6b95c159b355b38135760ccb293ce89ae2084d79c2cf1007a3871f4
TEKSTI	61d2aac6462b14c8b20c553ec61ee77e96f5acacdfbab268992e773cb4cde9df
PAMJA	9a63b1bf41656d8c655b4d730b62515e07280b3e6db12f16686a280324f8cea5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	77cdefb5aeb7dcc79b26bc1b0c07f449f62f7dd98c470099769aea5d4747f554
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7c88a06e0fb29d00749f8a614584e9cdeb31578c3796508ccc57680d8788f332
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/77cdefb5aeb7dcc79b26bc1b0c07f449f62f7dd98c470099769aea5d4747f554>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Katër faktorët që e bëjnë Barcelonën pretendente për Ligën e Kampionëve këtë sezon



Barcelona është renditur mes skuadrave favorite për triumfin në Ligën e Kampionëve në sezonin 2026/27, pas një vere ku drejtuesit katalunas ndërmorën disa hapa të rëndësishëm në merkato.

Klubi synon t'i rikthehet majës së futbollit evropian pas 11 vitesh pritjeje. Me Hansi Flickun në stol, skuadra duket më e plotë dhe më konkurruese krahasuar me sezonet e fundit.

Përforcimet e realizuara nga drejtori sportiv Deco, së bashku me përmirësimin e lojtarëve që ishin tashmë pjesë e ekipit, kanë krijuar një formacion që mund të përballët me kundërshtarë të çdo niveli.

Këto janë katër arsyt kryesore që e ushqejnë besimin se Barcelona mund të shkojë deri në fund në Ligën e Kampionëve.

Një prej pikave më të forta të Barcelonës është puna e bërë gjatë afatit kalimtar. Klubi katalunas realizoi shtatë transferime dhe përforcoi thujtë çdo repart të skuadrës.

Jesse Bisiwu shihet si një investim për të ardhmen, ndërsa portieri kroat Dominik Livakovic u afrua për të qenë zëvendësuesi i Joan Garcias.

Megjithatë, pritshmëritë më të mëdha lidhen me emrat që pritet të kenë ndikim të menjëhershëm në lojën e ekipit.

Anthony Gordon kaloi nga Newcastle United për 70 milionë euro dhe firmosi kontratë deri në qershor të vitit 2031. Sulmuesi anglez e ka nisur në mënyrë mbresëlënëse aventurën e tij, me pesë asistime në po aq ndeshje në të gjitha garat.

Prania e Gordonit i ka shtuar Barcelonës ritëm, shpejtësi në sulmet vertikale dhe intensitet në krahun e majtë.

Karim Adeyemi u ble nga Borussia Dortmundi për 22 milionë euro dhe deri tani ka dhënë shenja inkurajuese.

të fundit /



Real Madridi bind ndaj Rayo Vallecanos dhe rikthehet te fitorja në ...



Ceuta përballët me pasojat e fluksit të emigrantëve, rreth 13...



Protesta e 105 vijon prej mbi 3 orësh: Diaspora rrethon...



Temperaturat rekord rrisin alkoolin e shampanjës, prodhue...



Rama në Vlorë për hartën territoriale: Bashkitë do të...



Arsenali vazhdon serinë e fitoreve, mposht Sunderlandin...



Ngruhja globale ndryshon shampanjën, Franca lejon...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Gjermani ka realizuar dy gola dhe një asistim në pesë paraqitje, ndërsa ka shënuar edhe në debutimin e tij në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve.

Pas një tjetër huazimi, Joao Cancelo u transferua përfundimisht te Barcelona dhe nënshkroi deri në qershor të vitit 2029. Mbrojtësi portugez i ofron ekipit përvojë dhe forcë shpërthyesë në të dy krahët e fushës.

Gabriel Jesus iu bashkua skuadrës në ditët e fundit të merkatos. Pasi nuk arriti të siguronte transferimin e Julian Alvarezit nga Atletico Madridi, Barcelona zgjodhi brazilianin, i cili nuk po gjente hapësirën e duhur te Arsenali. Transferimi kushtoi 10 milionë euro dhe Jesus ka shënuar një gol në dy paraqitje.

Megjithatë, afrimi më i bujshëm ishte ai i Rodrit. Barcelona pagoi 60 milionë euro për kapitenin e Kombëtares së Spanjës, i cili ka kontratë deri në qershor të vitit 2030. Fituesi i Topit të Artë për vitin 2024 po i jep mesfushës katalunase një dimension të ri.

Falë këtyre lëvizjeve, Barcelona ka fituar më shumë cilësi në të gjitha repartet dhe duket më e përgatitur për sfidat e fazës vendimtare të sezonit.

Një tjetër element që ka sjellë optimizëm është roli i ri i Raphinhas. Braziliani, i cili këtë sezon është emëruar edhe kapiten, ka marrë përgjegjësi më të mëdha dhe po tregon se mund të jetë vendimtar edhe kur luan në qendër të sulmit.

Pasi dështoi për ta sjellë Julian Alvarezin, Flick vendosi të gjente zgjidhjen brenda grupit. Kështu, Raphinha u zhvendos nga krahu në pozitën e qendërsulmuesit.

Eksperimenti ka funksionuar në mënyrë të shkëlqyer. Në vetëm pesë ndeshje, braziliani ka shënuar tetë gola dhe ka dhuruar një asistim. Në përballjen me Feyenoordin në Ligën e Kampionëve, ai realizoi dy gola.

Në rolin e numrit 9, Raphinha i jep sulmit të Barcelonës më shumë alternativa. Angazhimi i tij pa top është veçanërisht i rëndësishëm, pasi presingu nis që në zonën e kundërshtarit dhe mbrojtësit vendosen vazhdimisht nën presion.

Shpejtësia e brazilianit e ndihmon ekipin të luajë më vertikalisht, ndërsa depërtimet e tij në thellësi hapin korridore për bashkëlojtarët. Në të njëjtën kohë, ai ka ruajtur instinktin për të shënuar, duke e bërë edhe më kërcënues repartin ofensiv të Flickut.

Nëse një transferim mund të konsiderohet vendimtar për rritjen e nivelit të Barcelonës, ai është padyshim Rodri.

Për ta mposhtur konkurrencën e Real Madridit dhe për ta bindur kapitenin e Spanjës të transferohej në Camp Nou, klubi katalunas bëri një investim të madh financiar.

Rodri shkëlqeu me Kombëtaren e Spanjës në Kupën e Botës 2026 dhe tashmë është rikthyer në formën e tij më të mirë. Përshtatja me idetë e Flickut ka qenë gjithashtu e shpejtë.

Te Barcelona, ai po aktivizohet kryesisht si mesfushor defensiv përpara mbrojtjes. Nga aty, ai nis aksionet, administron ritmin e lojës dhe krijon bazën për ndërtimin e sulmeve.

Prania e tij i ka dhënë Pedrit më shumë liri për të avancuar dhe për të marrë përsipër detyra krijuese.

Ndeshja ndaj Valencias e ilustron më së miri ndikimin e Rodrit. Ai preku topin 83 herë, humbi vetëm dy topa dhe kompletoi 81 nga 83 pasimet e tij, me saktësi prej 98 për qind.

Në gjysmën e fushës së Valencias, mesfushori realizoi 54 nga 55 pasime dhe ishte i saktë në të pesë pasimet e gjata. Në mbrojtje, ai rikuperoi gjashtë topa, kreu një ndërhyrje dhe një interceptim. Të gjitha këto statistika u regjistruan në vetëm 62 minuta, në startin e tij të parë, në një takim të fituar nga Barcelona 5-0.

Rodri nuk kufizohet vetëm te rikuperimi i topit. Ai është në gjendje të diktojë ritmin, të mbajë posedimin, ta fitojë sërish topin dhe menjëherë të ndërtojë aksionin pasues.

Barcelona ka dhënë gjithashtu shenja se mund të jetë më e ekuilibruar këtë sezon. Në pesë ndeshjet e para, katër në La Liga dhe një në Ligën e Kampionëve, skuadra e Flickut ka pësuar vetëm tri gola: dy ndaj Rayo Vallecanos dhe një kundër Feyenoordit.

Pau Cubarsi, edhe pse vetëm 19-vjeçar, është shfaqur si një nga figurat drejtuese të mbrojtjes. Pjekuria e tij në repartin defensiv ka qenë një ndër aspektet më pozitive të startit të sezonit.

Rodri, i vendosur përpara vijës së mbrojtjes, shton një tjetër garanci sigurie dhe ndihmon që aksionet e kundërshtarëve të ndërpriten që në fazat e para.

Paralelisht, sulmi katalunas po prodhon shifra të jashtëzakonshme. Në pesë ndeshje, Barcelona ka shënuar 22 gola, me një mesatare prej më shumë se katër golash për takim. Raphinha kryeson listën e golashënuesve me tetë realizime, ndërsa pas tij renditet Lamine Yamal me pesë.

Me Gordonin, Adeyemin, Raphinha, Yamal dhe pjesën tjetër të lojtarëve ofensivë, Barcelona ka shumë mënyra për t'i shkaktuar dëme çdo kundërshtari. Kjo larmi në sulm mund të kthehet në një nga avantazhet kryesore të skuadrës në Ligën e Kampionëve.

Skuadra e Flickut duket tashmë më e thellë, më e balancuar dhe më e kompletuar. Rodri kontrollon mesfushën, Raphinha po shkëlqen si numër 9, ndërsa sulmi po shënon me një ritëm të jashtëzakonshëm.

Nëse Barcelona arrin ta ruajë këtë nivel deri në muajt vendimtarë, ajo ka arsye të forta për të besuar se mund ta rikthejë trofeun e Ligës së Kampionëve në Kataluni, t'i japë fund dominimit të Paris Saint-Germainit dhe ta fitojë për herë të gjashtë në histori trofeun më prestigjioz të futbollit evropian.

Shtuar më 12.09.2026 23:20

Tags: [BARCELONA](#) , [Liga e Kampionëve](#)



Real Madridi bind ndaj Rayo Vallecanos dhe rikthehet te fitorja në La...



Arsenali vazhdon serinë e fitoreve, mposht Sunderlandin në transfertë



Qardaku vulosi fitoren e Dinamos ndaj Partizanit: Jemi në rrugën e duhur



Lorenc Trashi humbi ndjenjat gjatë ndeshjes, ja si paraqitet gjendja e...



Zbulohen arsyet pse dështoi transferimi i Eduardo Camavingas te...



Elvis Plori largohet nga drejtimi i Besëlidhjes pas humbjes me Korabin



Mourinho i kërkon Perezit përforsimin e mesfushës, rikthehet synimi për talen...



Muço Boçi, "Lojtari i Ndeshjes": "I lumtur për këtë fitore"; nuk flitet kaq...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

[Erion Veliaj](#)
[Free Esim](#)
[Zgjedhjet 2025](#)
[Belinda Balluku](#)
[SPAK](#)
[Kombëtarja](#)

Kategori

[Lifestyle](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Shëndetësi](#)
[Argetim](#)
[Enciklopedi](#)

Linqet

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Tags

[Edi Rama](#)
[Albania News](#)
[Ilir Meta](#)
[Piranjat](#)
[gazeta, tv, portale](#)
[Sali Berisha](#)

Moti

[Moti në Tiranë](#)
[Moti në Prishtinë](#)
[Moti në Shkup](#)
[Moti në Durrës](#)
[Moti në Prizren](#)
[Moti në Tetovë](#)

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.